

K O M E N T

Pershendetje

Pyetjet qe shtrohen per koment

1. Ne cilen rubriken duhet raportuar vlera e punes nga shoqerite Fason ?

Ne rubriken 11 Eksporte mallrash apo

Ne rubriken 12 Furnizime me shkalle 0% ?

2. Po statusin e Eksportuesit me rrisht zero kush e perfiton ?

Ata qe raportojne ne rubriken 11 Eksporte mallrash **apo edhe**

Ata qe raportojne ne rubriken 12 Furnizime me shkalle 0% ?

Nisur nga pyetja e pare , **nje pergjigje e shpejte dhe jo e sakte** do te ishte; çberi 11 e çberi 12. ndersa nje pergjigje e sakte do te ishte raportimi duhet ne ate rubrike qe percakton rregulli (udhezimi).

Nisur nga pyetja e dyte,

1.Me raportimin ne **rubriken 11** si Eksport Mallrash, sipas administrates tatimore, **e perfiton statusin** e Eksportuesit me rrisht zero dhe rimbursimi behet automatikisht brenda 30 diteve.

2.Me raportimin ne **rubriken 12** si Furnizime me shkalle 0%, sipas administrates tatimore **nuk e perfiton statusin** e Eksportuesit me rrisht zero dhe rimbursimi nuk behet automatikisht brenda 30 diteve, por pas kontrollit tatimor.

Ky problem i doli kolegut dhe shokut tim Arben Hasani, dhe kerkoi interpretim te DPT.

Pergjigja e interpretimit ka zgjidhur problemin e tij, por, me lejen e tij, po e bej prezent dhe per kedo qe ka interes nga kjo zgjidhje.

Se Pari: Per raportimin

1. Argumentimi ligjor.

Ligji 92/2014 dt. 24/07/2014 per Tvsh-ne dhe Udhezimit perkates Nr 6 date 31/01/2015 ne formularin e FDP-se rubrikat e deklarimit te shitjeve me 0% TVSH nga nje e vetme (me ligjin e vjeter) u bene tre dhe konkretisht sot kemi :

Rubrika (10) Shitje pa TVSH
Rubrika (11) Eksporte mallrash
Rubrika (12) Furnizime me shkalle 0%

Ne udhezimin e plotesimit te FDP-se thuhet:

- Rubrika (11) duhet plotesuar me totalin e eksportit te mallrave me shkalle tatimore 0%
- Rubrika (12) plotesohet me Furnizimet sipas Kapitullit 8 Seksioni 3 te ligjit te TVSH pervec eksportit te mallrave qe deklarohet ne rubriken (11)

Per kete te fundit kemi:

Në ligjin e TVSH 92/2014 Kapitulli 8 Seksioni 3 Neni 57 trajtohen Furnizimet me shkalle 0% TVSH dhe ne piken ç) thuhet:

ç) furnizimi i shërbimeve që konsistojnë në punime mbi mallra të luajtshme të importuara për t'u bërë atyre punime në Republikën e Shqipërisë dhe të dërguara apo të transportuara sërish jashtë Republikës së Shqipërisë nga furnizuesi i shërbimit apo nga destinuesi i shërbimeve, të cilët nuk janë vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë ose për llogari të tyre;

Ne Udhezimin e TVSH nr 6 Neni 48 pika b) thuhet:

b) Furnizimi i shërbimit të përpunimit të mallrave jo-shqiptare të kryera nga eksportuesi, të klasifikuara nën regjimin e përpunimit aktiv (punët fason) shërbime, të cilat i shtojnë vlerën mallit të përpunuar të destinuar për t'u ri-eksportuar janë furnizime me shkallë zero% të TVSH

2. Interpretimi i DPT.

Ky interpretim me shkresen 24280/1 date 10.11.2017 (bashkangjitur) eshte ne koherence me ligjin si dhe u argumentua me siper dhe konkretisht:

Ne paragrafin e gjashte kemi:

Bazuar ne referencat marra ligjore te me siperpermendura operatori eksportues, per punen e kryer (furnizim sherbimi) mbi mallrat eshte i detyruarte leshoje fature e cila i bashkangjitet deklarates doganore te ri-eksportit te ketyre mallrave dhe kjo fature deklarohet ne librat e shitjes ne rubriken “furnizime me shkalle 0%”.

Ne perfundim te ketij argumenti kemi:

Raportimi duhet bere ne rubriken 12 Furnizime me shkalle 0%

Se Dyti: Per rimbursimin e tvsh-se

1. Argumentimi ligjor.

- Ligji 92/2014 dt. 24/07/2014 per Tvsh-ne ne nenin 77 pika 3 thekson

3. Eksportuesit kanë të drejtë të kërkojnë rimbursim kur teprica e tyre tejkalon shumën 400.000 (katërqind mijë) lekë. Këshilli i Ministrave përcakton kategorinë e eksportuesve sipas këtij neni.

- VKM 953, dt. 29.12.2014 Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014, “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë” neni 10 pika 1 (Ndryshimi i bere me VKM 460 dt.22.06.2016.) thekson:

1. Për qëllime të rimbursimit të TVSH-së, kategoritë e eksportuesve në zbatim të pikës 3, të

nenit 77, të ligjit, janë personat e tatueshëm eksportues, si dhe personat e tatueshëm që riekportojnë mallrat joshqiptare nën regjimin e përpunimit aktiv në Republikën e Shqipërisë, siç përcaktohet në Kodin Doganor, të cilët plotësojnë njëkohësisht kriteret e mëposhtme:

- a) Vlera e eksporteve të kryera në periudhën/at tatimore, për të cilën/at kërkohet rimbursim, është më shumë se 70% e vlerës së përgjithshme të shitjeve, përfshirë eksportet;
- b) Kanë aktivitet eksportues mbi 1 vit;
- c) Paraqesin si dokument prove të kryerjes së eksportit deklaratën doganore të eksportit, lëshuar sipas legjislacionit doganor në Republikën e Shqipërisë;
- ç) Nuk kanë detyrime të papaguara të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

2. Interpretimi i DPT.

Ne paragrafin e shtatë të shkresës së sipërcituar kemi:

*Persa i perket përfitimit të statusit të eksportuesit me risk zero të shoqërive fason, në konsideratë të VKM 953, dt. 29.12.2014 Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014, "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë" I ndryshuar, në nenin 10 "Përcaktimi i kategorisë së eksportuesve për qëllim të rimbursimit të TVSH-së", pika 1, është përcaktuar se, për qëllim të rimbursimit të tvsh-se, kategoritë e eksportuesve në zbatim të pikës 3, të nenit 77, të ligjit, janë personat e tatueshëm eksportues, si dhe **personat e tatueshëm që riekportojnë mallrat joshqiptare nën regjimin e përpunimit aktiv** në Republikën e Shqipërisë, siç përcaktohet në Kodin Doganor, të cilët plotësojnë njëkohësisht kriteret e mëposhtme:*

- a) Vlera e eksporteve të kryera në periudhën/at tatimore, për të cilën/at kërkohet rimbursim, është më shumë se 70% e vlerës së përgjithshme të shitjeve, përfshirë eksportet;
- b) Kanë aktivitet eksportues mbi 1 vit;
- c) Paraqesin si dokument prove të kryerjes së eksportit deklaratën doganore të eksportit, lëshuar sipas legjislacionit doganor në Republikën e Shqipërisë;
- ç) Nuk kanë detyrime të papaguara të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Në përfundim të këtij argumenti del arsyetimi sa ligjor aq dhe llogjik që:

Përfitimi i statusit të eksportuesit me risk zero dhe rimbursimi i tvsh-se në mënyrë automatike brenda 30 ditëve nuk ka lidhje me mënyrën e raportimit (e cila është rregull dhe duhet zbatuar), por me kushtet që përcakton kuadri ligjor si më sipër.

Ose e thënë ndryshe

Kur plotëson kushtet, rimbursimi i Tvsh-se bëhet automatikisht brenda 30 ditëve nga kërkesa, pavarësisht ku e ke raportuar, në kutinë 11 apo në kutinë 12 (duke ritheksuar që raportimi i rregullt dhe ligjor është në kutinë 12 Furnizime me shkallë 0%).

Duke ju falenderuar,
me poshtë shkresë e DPT drejtuar z.Arben Hasani Kontabel i Miratuar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE
DREJTORIA LIGJORE DHE TEKNIKE
SEKTORI TEKNIK

Nr. 24280/Prot.

Tiranë, më 10.10.2017

Lënda: Kthim përgjigje

“ARBEN HASANI” P.F NIPT K72028052F
Adresa: Blv. “Gjergj Fishta”, Bld E-88, Office 11

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj, datë 17.10.2017 me lëndë “Kërkesë për interpretim të deklarimeve të vlerës së përpunimit FASON”, protokolluar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve me Nr.24280 Prot., datë 20.10.2017, sqarojmë si më poshtë:

Bazuar në Ligjin nr.92/2014, datë 24.07.2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 57 “Eksportet”, pika “ç” dhe udhëzimin Nr.6 datë 30.01.2015 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 48 është përcaktuar krahas të tjerave se, konsiderohen furnizime me shkallë zero të TVSH-së transaksionet e eksportit që kanë të bëjnë me *furnizimin e shërbimeve që konsistojnë në punime mbi mallra të luajtshme të importuara për t’u bërë atyre punime në Republikën e Shqipërisë dhe të dërguara apo të transportuara sërish jashtë Republikës së Shqipërisë nga furnizuesi i shërbimit apo nga destinuesi i shërbimeve, të cilët nuk janë vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë ose për llogari të tyre.*

Kompanitë të cilat kryejnë furnizime shërbimi të përpunimit të mallrave jo-shqiptare të klasifikuara nën regjimin e përpunimit aktiv (punët fason), shërbime të cilat i shtojnë vlerën (puna), në radhë të parë duhet të jenë të pajisura me autorizimin përkatës prej autoritetit doganor dhe ky i fundit të mbajë ose të sigurojë mbajtjen e regjistrave të magazinimit të mallit, “regjistra të përpunimit aktiv”, të cilat tregojnë sasinë e mallrave të importuara të vendosura nën regjim dhe sasinë e produkteve kompensuese kryesore të përftuara.

Materialet e sjella nga porositësi në formën e lëndës së parë mbi bazën e një kontrate prosie, duhet t’i kthehen këtij të fundit, fizikisht nga përpunuesi në formën e gjysmëproduktit ose produktit të gatshëm, me përjashtim të mbetjeve teknologjike gjatë procesit të prodhimit dhe në përputhje me kartat teknologjike të prodhimit. Kjo kërkon si domosdoshmëri, që këto materiale të jenë të identifikuar me dokumentacionin përkatës, përgjatë gjithë kohës së përpunimit.

Pra, përpunuesi asnjëherë nuk duhet të bëhet pronar i materialeve të sjella nga porositi sepse importet e kryera (materiale, lëndë e pare, mallra gjysëm të gatëshme) janë importe të natyrës jo tregtare.

Bazuar në referencat ligjore të sipërpërmëndura operatori eksportues, për punën e kryer (furnizim shërbimi) mbi mallrat e marra është i detyruar të lëshojë faturë e cila i bashkëngjitet deklaratës doganore të ri-eksportit të këtyre mallrave dhe kjo faturë deklarohet në librat e shitjes në rubrikën “furnizime me shkallë 0%”

Përsa i përket përfitimit të statusit të eksportuesit me risk zero të shoqërive fason, në konsideratë të vendimit Nr.953, datë 29.12.2014 “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014, “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 10 “Përcaktimi i kategorisë së eksportuesve për qëllim të rimbursimit të TVSH-së”, pika 1, është përcaktuar se, për qëllime të rimbursimit të TVSH-së, kategoritë e eksportuesve në zbatim të pikës 3, të nenit 77, të ligjit, janë personat e tatueshëm eksportues, si dhe **personat e tatueshëm që riekportojnë mallrat joshqiptare nën regjimin e përpunimit aktiv** në Republikën e Shqipërisë, siç përcaktohet në Kodin Doganor, të cilët plotësojnë njëkohësisht kriteret e mëposhtme:

- a) Vlera e eksporteve të kryera në periudhën/at tatimore, për të cilën/at kërkohet rimbursim, është më shumë se 70% e vlerës së përgjithshme të shitjeve, përfshirë eksportet;
- b) Kanë aktivitet eksportues mbi 1 vit;
- c) Paraqesin si dokument prove të kryerjes së eksportit deklaratën doganore të eksportit, lëshuar sipas legjislacionit doganor në Republikën e Shqipërisë;
- ç) Nuk kanë detyrime të papaguara të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Pësa sipër, referuar dispozitave ligjore tatimore, zbatimi korrekt i tyre mbetet një detyrim dhe përgjegjësi e tatimpaguesit dhe është Drejtoria Rajonale Tatimore ku ju jeni të regjistruar, e cila kontrollon zbatimin korrekt të legjislacionit tatimor nga ana e subjektit tuaj.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Vasilika Vjero

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZV/DREJTORI I PËRGJITHSHËM**

Xhavit Çurri

